VENDIM
Nr. 841, datë 5.11.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 278, DATË 29.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI 'SISTEMIM RRUGËSH, BLLOKU 'PËRROI I ÇAPRAZIT', POGRADEC'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 278, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti 'Sistemim rrugësh, blloku 'Përroi i Çaprazit', Pogradec'", bëhen këto ndryshime:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera "... 23 003 616 (njëzet e tre milionë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekësh ..." zëvendësohet me "... 27 514 746 (njëzet e shtatë milionë e pesëqind e katërmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet e gjashtë) lekësh ...";

b) Të dhënat për shpronësim të numrit rendor 7 të tabelës, bashkëlidhur vendimit nr. 278, datë 29.4.2022, zëvendësohen me të dhënat me të njëjtin numër rendor të tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Bashkisë Pogradec.

3. Bashkëpronarët e pasurisë të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në numrin rendor 7 të tabelës, bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

4. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e bashkëpronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, Bashkia Pogradec dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI “SISTEMIM RRUGËSH BLLOKU ‘PËRROI I ÇAPRAZIT’, POGRADEC”

Nr.	Emër Mbiemër			Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Shënime
7	Vasil	Kostaq	Marko	8582	14/146	Trualll	m^2	627	10,491	6,577,857	
	Petro	Kostaq	Marko								
	Kristaq	Kostaq	Marko								
	Violentina	Jorgji	Bixheku								
	Marie	Jorgji	Nasho								
	Vlash	Jorgji	Tiri								
	Eliverta	Naum	Marko								
	Valentina	Naum	Cici								
	Ilias	Skender	Marko								
	Migela	Skender	Xhani(Marko)								
	Artan	Skender	Marko								
	Bardhyl	Naum	Marko								
	Aleksandra	Naum	Marko								
	Roza	Naum	Marko								
	Vladimir	Naum	Marko								
	Kaliopi	Naum	Marko								
	Liliana	Vasil	Marko								
	Denada	Vergjil	Marko								
	Ervin	Vergjil	Marko								
	Shuma totale e shpronësimit									**6,577,857.00**	
Efekti financiar shtesë është 4,511,130 lekë											